



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:208944
Datë: 25.10.2024
Numri i dokumentit: 06348946

C.nr.7602/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.S. "E." Sh.a.,- me seli në P., rr. ".....", nr....., kundër të paditurit V.K., nga fsh. P., Komuna e P., me objekt kontesti rimbursim i dëmit, me vlerë të kontestit 1,079.00 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Për shkak të pa dëgjueshmërisë /mosbindjes

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K.S. "E." sh.a., me seli në P., dhe DETYROHET i padituri V.K., nga fsh. P., Komuna e P., që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 25.04.2020 t'ia kompensoj shumën prej 1,079.00€, me kamatë ligjore 8%, nga data 24.10.2024 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30.00 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 16.09.2021 pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurit, për rimbursim të dëmit. Në padi është theksuar se i padituri më datë 25.04.2020, kishte shkaktuar aksident trafiku me automjetin e markës, me targa, të cilin e drejtonte pa patent shofer. Ka shtuar se paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarve dëmin material dhe jo material të pësuar si rezultat i aksidentit. Andaj, duke i pasur parasysh ato që u thanë më lartë, ka kërkuar nga Gjykata që ta detyroj të paditurin që në emër të regresit t'ia paguaj shumën prej 1,079.00€, kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata, me aktvendimin C.nr.7602/21 të datës 26.01.2022 e ka detyruar të paditurin që të përgjigjet në padi, nën paralajmërimin që nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes.

I padituri, edhe pse aktvendimin C.nr.7602/21 të datës 26.01.2022, e ka pranuar me datë 07.02.2022, nuk ka parashtruar përgjigje në padi, andaj gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për të marrë aktgjykim, për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 150 paragrafi 1 pikat a, b dhe c, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Andaj, mbi këtë bazë ligjore, gjykata, nga provat e bashkangjitura në padinë e paditëses gjeti se fillimisht, raporti i policisë lidhur me aksidentin me numër, ka vërtetuar se me datë në ora 09:10, në P., është shkaktuar aksident në komunikacionin rrugor, në mes automjetit markës, të cilin e drejtonte i padituri me automjetin e markës me targa, në pronësi të A.Sh., të cilin e drejtonte H.Sh. Po ashtu nga ky raport gjykata ka vërtetuar dhe se i padituri në atë moment nuk ishte në posedim të patentë shoferit.

Nga marrëveshjet jashtë gjyqësore të datës 05.06.2020, të lidhur në mes të K.S.“E.”, dhe përfaqësuesit të dëmtuarve A.Sh. dhe H.Sh., vërtetohet se është arritur marrëveshja që pala e dëmtuar në këtë aksident të kompensohet dhe atë A.Sh. në shumë prej 400.00 € ndërsa H.Sh., në shumë prej 679.00 €.

Përmes urdhër transferit, vërtetohet se është transferuar shuma e mjeteve në vlerë të përgjithshme prej 1,079.00 €.

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr. 04/L-018 përkatësisht neni 14 par. 1 pika 1.2 të LSDA-së përcakton se: *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”*. Neni 18 i po këtij ligji ka paraparë se *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Kompania”*. Ndërsa me dispozitat e nenit 14.3 të LSDA-së, është e paraparë se *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*

Me aplikimin e këtyre normave ligjore, paditësja ka të drejtë të kërkojë regres nga shkaktpari i dëmit, i cili nuk ka patentë shofer në momentin e shkaktpimit të aksidentit, për dëmet që i janë kompensuar personave të tretë të dëmtuar. Përmes provave është arritur deri tek gjendja faktike e vërtetuar se i padituri nuk ka pasur patentë shofer, si dhe është vërtetuar se shuma e mjeteve monetare që pala e dëmtuar ka realizuar nga paditësja,, që rrjedhimisht nënkupton detyrimin e të paditurit për regres.

Në bazë të nenit 245 par.1 i Ligjit Nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Së këndejmi, mbi bazën e të gjitha provave, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e këtyre provave, në pajtim me nenin 150.1 të LPK-së, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit, gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t’ia paguaj edhe kamatën ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 452 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet taksës gjyqësore në shumë prej 30€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 7602/21, datë 24.10.2024.

Gjyqtarja
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.